

20121363363

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN
E LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 31/98, 49/2003, 82/2005, 116/10, 47/11 dhe 51/11), në nenin 11-b paragrafi (5) fjalët: "vendos ministri i Kulturës" zëvendësohet me fjalët: "ministri i Kulturës, në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni, miraton aktvendim".

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (5) të këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë."

Paragrafi (6) bëhet paragrafi (7).

Neni 2

Në nenin 16 pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5) si vijojnë:

"(4) Ministri i Kulturës për propozimin nga paragrafi (3) i këtij neni, në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, miraton aktvendim.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita marrjes së aktvendimit, në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë."

Neni 3

Neni 23 shlyhet.

Neni 4

Neni 41 shlyhet.

Neni 5

Në nenin 67 pas paragrafit (2) shtohen tre paragrafë të rinj (3), (4) dhe (5), si vijojnë:

"(3) Në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Programit vjetor, ministri i Kulturës miraton aktvendim për kërkesat e pjesëmarrësve në konkursin publik për realizimin e të drejtës për pjesëmarrje në financimin e projekteve që janë me interes nacional.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(5) Ankesa nuk e prolongon zbatimin."

Neni 6

Procedurat për përcaktimin e të drejtës së kompensimit mujor në para nga neni 11-b, për ndarjen e kompensimeve mujore nga neni 16 dhe procedura për miratimin e programit vjetor nga neni 67 të këtij ligji, të filluara para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".